



Raporti, Izveštaj, Report / 2016

**Reflektim mbi të drejtat LGBTI në Kosovë**  
**Razmatranja o pravima LGBTI zajednice na Kosovu**  
**Reflections on LGBTI Rights in Kosovo**



Supported by the European Union



Financed by:



Supported by

**Botuesit:**

Qendra për barazi dhe liri – CEL

Qendra për zhvillimin e grupeve shoqërore – CSGD

**Redaktorët:**

Rajmonda Sylbije

Arbër Nuhiu

**Dizajni & shtypi:**

Printing Press

**Kopje:**

500

Ky Raport është pjesë e projektit “Shfrytëzimi i proceseve të anëtarësimit në BE, për zhvillimin e të drejtave LGBT në Ballkanin Perëndimor” dhe mbështetet nga Sarajevski Otvoreni Centar SOC (Qendra e Hapur Sarajevë).

**Deklaratë Mohimi**

Ky publikim është prodhuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e CEL dhe CSGD dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

**Të drejtat e autorit**

© Qendra për barazi dhe liri – CEL dhe Qendra për zhvillimin e grupeve shoqërore – CSGD, dhjetor 2016. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtëritëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo me çfarëdo lloj mjeti, elektronik, mekanik, foto-kopjim, regjistruar apo tjetër, pa lejen paraprake të CEL dhe CSGD.



# Raporti vjetor 2016

## Reflektim mbi të drejtat LGBTI në Kosovë



Përkrahur nga Bashkimi Evropian



Financuar nga:



Mbështetur nga:





## Tabela e përmbajtjes

Shkurtesat .....	4
Përmbledhja Ekzekutive .....	5
Hyrja .....	6
Legjislacioni .....	8
Përgjegjësia institucionale për të drejtat LGBTI .....	10
Zbatimi i ligjit në lidhje me të drejtat LGBTI .....	14
Institucionet dhe mekanizmat e të drejtave të njeriut në relacion me të drejtat LGBTI..	15
Raportimi i mediave në lidhje me çështjet LGBTI .....	17
Kontributi i organizatave LGBTI .....	17
Sulmet ndaj aktivistëve LGBTI .....	20
Mbrojtësit e rrejshëm të të drejtave të njeriut .....	21
Rastet e raportuara para institucioneve relevante .....	23
1. Rasti i parë i zgjidhur nga gjykata .....	23
2. Rasti i çiftit gej që u dëbua me forcë nga banesa nga qiradhënësi i tyre .....	24
3. Rasti i dhunës në familje ndaj një të mituri .....	24
4. Rasti para Gjykatës Themelore - Departamentit të Krimeve të Rënda .....	25
Rekomandime .....	26



## Shkurtesa

GKK - Grupi Këshillues dhe Koordinues për të drejtat LGBTI

KPRK – Kodi Penal i Republikës së Kosovës

CEL – Center for Equality and Liberty - Qendra për Liri dhe Barazi

CSGD – Center for Social Group Development - Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore

ERA - LGBTI Equal Rights Association for Western Balkans and Turkey - Asociacioni për të Drejta të Barabarta LGBTI për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë

BE - Bashkimi Evropian

HIV/AIDS - Human Immunodeficiency Virus Infection/Acquired Immune Deficiency Syndrome - Virus që sulmon imunitetin

NDNj - Njësi i të Drejtave të Njeriut

IDAHO - International Day against Homophobia and Transphobia - Dita Ndërkombëtare kundër Homofobisë dhe Transfobisë

LGBTI – Lezbike, Gej, Biseksual, Transgjjinor dhe Interseks

MASHT – Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

OJQ - Organizatë Jo-Qeveritare

ZQM - Zyra për Qeverisje të Mirë (Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta, dhe kundër Diskriminimit)

IAP - Institucioni i Avokatit të Popullit

QESH – Qendra për Emancipim Shoqëror



## Përmbledhja Ekzekutive

Avancimi i të drejtave LGBTI në Kosovë po kalon nëpër një rrugë me shumë sfida. Sikurse në vendet tjera, vlerat patriarkale të shoqërisë, që përforcohen më tej nga praktikimet tradicionale dhe shpeshherë ekstreme religjioze, janë ende pengesë kryesore për të drejtat LGBTI. Për më tepër, avancimi i të drejtave LGBTI në Kosovë pengohet nga mungesa e kapaciteteve shtetërore për të zbatuar sundimin e ligjit. Kjo, mes tjerash, kontribuon në ruajtjen e hapësirës në mes të normave ligjore dhe shoqërore.

Ndonëse kështu vazhdon të jetë realiteti, komuniteti LGBTI në Kosovë është i marginalizuar dhe është në rrezik të vazhdueshëm nga dhuna. Duke ditur këtë, komuniteti LGBTI detyrohet që të jetojë fshehurazi, pa marrë parasysh garantimet e larta që jipen nga korniza ligjore e Kosovës. Pra nuk është i befasishtë fakti që për një pjesë të madhe të shoqërisë, përfshirë zyrtarë publik të të drejtave të njeriut dhe zbatues të ligjit, komuniteti LGBTI mbetet joekzistent, ose mishëron një normë të re të imponuar nga Perëndimi, që manifestohet nëpërmjet disa rasteve të izoluar të individëve LGBTI.

Me qëllim që të sjellë më shumë informata mbi këtë spektër të çështjeve të ndryshme, sikurse injoranca totale ndaj ekzistencës së komunitetit LGBTI, e deri te korniza më e avancuar ligjore që e ofron Kosova, ky raport do të shtjellojë disa pengesa konkrete të cilat janë hasur gjatë përpjekjeve për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat LGBTI gjatë vitit 2016. Nis me një analizë të shkurtër për situatën, si hyrje, e vazhdon më pas me një pasqyrë të kornizës relevante ligjore, duke theksuar mungesën e

dispozitave ligjore që lejojnë ndryshimin e gjinisë për personat transgjiorë, dhe korrigjimin e gjinisë në regjistra dhe dokumente publike; pengesat ligjore për martesë në mes të personave të seksit të njëjtë; dhe mungesën e dënimit të gjuhës dhe krimeve të urrejtjes me bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor në Kodin Penal. Për më tepër, raporti merr parasysh (mos)veprimet e institucioneve relevante gjatë përmbushjes së mandateve të tyre përkatëse në lidhje me mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave LGBTI, duke theksuar njëkohësisht pengesat e hasura, si për shembull gjuhën nënçmuese të përdorur nga anëtarët e Kuvendit; sfidat që parandalojnë punën efektive të Grupit Këshillues dhe Koordinues për të drejtat LGBTI; ngurrimin e Avokatit të Popullit dhe institucionit të tij për promovim të hapur dhe të gjërë të të drejtave LGBTI dhe për bashkëpunim më të mirë me organizatat LGBTI, dhe heshtjen e mosefektivitetin gati total të Njësiteve për të Drejtat e Njeriut në komuna në lidhje me të drejtat LGBTI.

Kur analizon raportimin e mediave për të drejtat LGBTI, raporti thekson çështjen e trajtimit të komenteve fyese nga mediat online. Raporti gjithashtu ofron një pasqyrë tematike për veprimet e tri organizatave LGBTI dhe rreziqet që i kanosen atyre, ilustruar me raste. Më pas jipet një përshkrim i kontributit të kufizuar për të drejtat LGBTI nga ana e organizatave tjera të të drejtave të njeriut, dhe i mungesës së sinqeritetit në misionet e tyre përkatëse, përsëri ilustruar me raste specifike. Përveç këtyre, raporti jep një përmbledhje të rasteve të dhunës kundër personave LGBTI që u raportuan në institucione relevante dhe mënyrën se si u trajtuan ato përkatësisht, e gjithashtu përfundon me një listë të rekomandimeve për institucione dhe OJQ.



## Hyrja

Avancimi dhe mbrojtja e të drejtave Lez-bike, Gej, Biseksual, Transgjjinor dhe Interseks (LGBTI) vazhdon të jetë një betejë e vazhdueshme në Kosovë. Hyrja në fuqi e legjislacionit liberal në lidhje me të drejtat e njeriut, që ka vendosur themelet për institucionet e reja të Kosovës, nuk i ka përfaqësuar domosdoshmërisht besimet shoqërore, dhe kjo është shpërfaqur më së qarti në rastin e të drejtave LGBTI. Vlerat e fuqishme patriarkale përbëjnë origjinën e hendekut së thellë në mes të frymës së ligjit dhe normave shoqërore që vazhdojnë të mbizotërojnë e të ushqehen nga sistemi i arsimit dhe sundimi joefektiv i ligjit. Si pasojë, vlerat patriarkale të shoqërisë kosovare mbesin shumë të pakundërshtuara, dhe kështu lënë hapësirë për praktika diskriminuese që miratohen nga "traditat". Kjo ka krijuar mundësinë që të drejtat LGBTI të mungojnë në fjalorin vendas të të drejtave të njeriut, ndërsa në shumë raste kur heshtja thyhet, jehon bindjen që të drejtat LGBTI janë normë e imponuar ndërkombëtarisht. Në përputhje me këto rethana, siç tregon raporti, një përqindje e lartë e zyrtarëve publik dhe zyrtarëve të sundimit të ligjit i perceptojnë çështjet LGBTI si të imponuara në Kosovë nga komuniteti ndërkombëtar<sup>1</sup>.

Kjo situatë ku ligji nuk përputhet me normat shoqërore ka mundësuar rritjen e nivelit të homofobisë, diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes në një anë, e ngurrimin e shërbyesve

civil në përmbushjen e detyrës së tyre për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave LGBTI në anën tjetër. Si rezultat, shumica e personave LGBTI jetojnë fshehurazi, ndërsa ata që janë të hapur për orientimin e tyre seksual ose perceptohen si anëtarë të komunitetit LGBTI ose përballen me forma të ndryshme të dhunës psikologjike dhe fizike prej familjes, shoqërisë, e edhe institucioneve. Për më tepër, të drejtat LGBTI nuk janë pjesë e politikave të partive politike, që në shumë raste refuzojnë që të adresojnë të drejtat LGBTI ose edhe të komentojnë për ato, nga frika që e humbjes së votave. Siç aludon sondazhi i opinionit nga Instituti Kombëtar Demokratik, 60% e publikut të përgjithshëm deklaruan që nuk do të votonin për një parti politike që i mbronë të drejtat LGBTI, edhe nëse ajo parti i adreson problemet më të rëndësishme në vend<sup>2</sup>. Kjo i ka dekurajuar partitë politike sa i përket qëndrimit pro të drejtave LGBTI; shumica e politikanëve bëjnë deklarata publike pro të drejtave LGBTI vetëm gjatë vizitave të përfaqësuesve të lartë ndërkombëtar, duke iu referuar legjislacionit progresiv të Kosovës, ndërsa gjuha nënçmuese e përfaqësuesve të partive politike dhe anëtarëve të Kuvendit është gati praktikë e qenësishme.

Raportimi nga ana e mediave, në anën tjetër, shpeshherë ka përforcuar perceptimet ekzistuese negative të shoqërisë drejt komunitetit LGBTI, dhe kështu mediat nuk kualifikohen si partnerë të mirë e të besueshëm për promovimin e të drejtave LGB-

---

<sup>1</sup> Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë dhe Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore, Liria dhe Mbrojtja për Lezbiket, Homoseksualët, Biseksualet dhe Transgjjinorët në Kosovë, (Prishtinë, Kosovë, nëntor 2013).

<sup>2</sup> Instituti Kombëtar Demokratik, Sondazhi Publik për LGBTI në Ballkanin Perëndimor, qershor/korrik 2015, (2015), [https://www.ndi.org/LGBTI\\_Balkans\\_poll](https://www.ndi.org/LGBTI_Balkans_poll).





TI. Ngjashëm edhe sistemi i arsimit përhapë gjuhë diskriminuese që kryesisht ka të bëjë me cilësimin e të qenit LGBTI si sjellje devijante ose sëmundje mendore, duke e ngulitur më tej këtë diskurs në diturinë publike e cila gjithashtu ndikon në formësimin e liderëve dhe profesionistëve të së ardhmës, dhe kështu kontribuon në ruajtjen e rrethit vicioz të homofobisë dhe diskriminimit. Për më tepër, rritja e nivelit të ekstremizmit religjioz e ka rritur edhe shpërndarjen e intolerancës dhe gjuhës e krimeve të urrejtjes kundër anëtarëve të komunitetit LGBTI. Nuk janë të rralla rastet kur liderët religjioz haptas përdorin dhe promovojnë gjuhë të

urrejtjes, dhe nxisin krime të urrejtjes, e këtë e bëjnë pa dhënë fare përgjegjësi, pavarësisht kufizimeve ligjore që janë në fuqi.

Me qëllim të mbushjes së këtij mozaiku mjaft kompleks të situatës së të drejtave LGBTI, ky raport ofron një analizë gjithëpërfshirëse të vitit 2016. Raporti nis me një pasqyrë të strukturës ligjore dhe institucionale relevante të të drejtave LGBTI në Kosovë, përcillet me një përmbledhje të veprimeve të ndërmarra nga organizatat e shoqërisë civile, dhe përfundon me një përshkrim të shkurtër të rasteve që ndodhën gjatë këtij viti të raportuar.

## Legjislacioni

Kushtetuta e Republikës së Kosovës është garantuese e lartë e të drejtave të njeriut. Vlerat e saja janë të ngulitura në parimet e të drejtave të njeriut, barazisë dhe mosdiskriminimit<sup>3</sup>, të precizuara në nenin 24 (1), ku deklarohet se të gjithë janë të barabartë para ligjit, dhe të gjithë gëzojnë të drejtën për mbrojtje të barabartë ligjore, pa diskriminim, dhe për më tepër ofrohet ndalimi i diskriminimit në bazë të gjinisë dhe orientimit seksual, si dhe stativeve tjera personale<sup>4</sup>. Kushtetuta gjithashtu garanton zbatueshmërinë direkte të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, përfshirë Kongresin Evropian për të Drejtat e Njeriut<sup>5</sup>, dhe interpretimin e të drejtave the lirive themelore të njeriut vazhdimisht në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vendimet<sup>6</sup> e së cilës mbivlerësohen para dispozitave të ligjeve kombëtare dhe veprimeve tjera të institucioneve publike<sup>7</sup>.

Ligjet e amandamentuara në vitin 2015 për Mbrojtje nga Diskriminimi<sup>8</sup> dhe Barazi Gjinore<sup>9</sup> gjithashtu sigurojnë garantime të larta për barazi dhe mosdiskriminim në bazë të orientimit seksual, gjinisë dhe identitetit gjinor, mes tjerash. Për më tepër, Ligji për Mbrojtje Kundër Diskriminimit ofron mbrojtje nga diskriminimi në sektorët publik

dhe privat, në lidhje me disa fusha, si në punësim, orientim dhe trajnim profesional, mbrojtje sociale, përparësi shoqërore, shërbime shoqërore, arsim, qasje në strehim, qasje në të mira dhe shërbime që janë në dispozicion për publikun, trajtim të drejtë në procedura gjyqësore, të drejta të pjesëmarrjes në shkencë dhe kulturë, sigurim personal, pjesëmarrje në sfera publike, qasje në hapësira publike dhe çfarëdo e drejte tjetër që sigurohet nga ligji<sup>10</sup>. Përveç kësaj, mbrojtja nga diskriminimi gjithashtu përcaktohet në ligjet relevante në këto fusha, por sa i përket bazave të mbrojtjes, ato mund të mos jenë edhe aq gjithëpërfshirëse sa Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi.

Përndryshe, në kundërshtim me parimet e barazisë që sigurohen nga Kushtetuta<sup>11</sup>, Ligji i Familjes kufizon aktet e fejesës dhe martesës si akte që mund të kryhen vetëm nga personat e gjinive të kundërta<sup>12</sup>, dhe kështu e bënë të paligjshme martesën në mes të personave të të njëjtit seks. Ndërsa Ligji për Status Civil<sup>13</sup> ka mungesë të dispozitave nënligjore për procesin e ndryshimit të gjinisë, dhe kështu ka mungesë të legjislacionit specifik që mundëson ndryshimin gjinisë, prandaj legjislacioni specifik i cili mundëson modifikimin e të dhënave në regjistra dhe dokumente publike, si dhe përshtatjen e të gjitha të dhënave tjera që kanë të bëjnë me individin, qofshin ato të sigurisë

<sup>3</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, k. I. neni 7 (1).

<sup>4</sup> Ibid, k. II, neni 24 (2).

<sup>5</sup> Ibid, k. II, neni 22.

<sup>6</sup> Ibid, k. II, neni 53.

<sup>7</sup> Ibid, k. II, neni 22.

<sup>8</sup> Ligji Nr. 05/L-021

<sup>9</sup> Ligji Nr. 05/L-020

<sup>10</sup> Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, 2015, k.I, neni 2.

<sup>11</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, k. II, neni 24, neni 37

<sup>12</sup> Ligji Nr.2004/32 Ligji për Familje i Kosovës, 2006, paragrafi II, k.I, neni 9, neni 14.

<sup>13</sup> Ligji Nr.04/L –003



sociale, pensionit apo taksave<sup>14</sup> është i nevojshëm që të vihet në dispozicion.

Ndërkohë, Komisioni i Kuvendit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, në qershor 2016 prezantoi raportin monitorues për zbatimin e Ligjit për Mbrojtje Kundër Dhunës në Familje, duke rekomanduar që ky ligj të amendamentohet, dhe të autorizohen disa politika që iu ndihmojnë viktimave të dhunës në familje<sup>15</sup>.

Ngjashëm në nëntor 2016 nisi<sup>16</sup> rishqyrtimi i Kodit Penal, pasi u kërkua nga Zyra e Presidentit. Kodi Penal aktual i Republikës së

Kosovës (KPRK) ofron përcaktime të krimeve dhe rrethanave që justifikojnë përgjegjësi kriminale për këto krime duke njohur më tej orientimin seksual, por jo edhe identitetin gjinor, si rrethanë rënduese<sup>17</sup>. Kësisoj as orientimi seksual e as identiteti gjinor nuk specifikohen si baza të mbrojtjura nga nxitja e urrejtjes<sup>18</sup>.

Në fund, pavarësisht strukturës së avancuar ligjore, me disa mangësi të shënuara për të cilat shpresohet të përmirësohen me kohë, pengesa kryesore ka të bëjë me zbatimin e këtyre ligjeve, dhe si pasojë, me sigurimin praktik të garantimeve të të drejtave të njeriut në përgjithësi, dhe të drejtave LGBTI në veçanti.

---

<sup>14</sup>Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore dhe Qendra për Liri dhe Barazi, Raport: Mbrojtje Sociale dhe Qasje në Shëndetësi për Personat Transgjinorë në Kosovë, (Prishtinë, Kosovë, dhjetor 2016).

<sup>15</sup> Komisioni i Kuvendit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Humbur dhe Peticione, Raport me Rekomandime për Monitorimin e Zbatimit të Ligjit Nr. 03 / L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, (30 qershor, 2016).

<sup>16</sup> "Nisin ndryshimet në Kodin Penal dhe të Procedurës Penale", KOHA.net, nëntor 21, 2016, qasur më 16 dhjetor, 2016, <http://koha.net/?id=27&l=143558>.

<sup>17</sup> Kodi Nr.04/L-082 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 2012, k. III, neni 74 (2.12).

<sup>18</sup> Ibid. k. XIV, neni 187 (1).

## Përgjegjësia institucionale për të drejtat LGBTI

### *Presidenti i Republikës së Kosovës Z.*

Hashim Thaçi bëri një hap të rëndësishëm për thyerjen e tabusë së të folurit haptas për të drejtat LGBTI dhe mbështetjes së tyre nga ana e liderëve politik dhe zyrtarëve të lartë shtetëror. Në fjalimin e tij përurues, Z. Thaçi theksoi diversitetin e shoqërisë kosovare dhe komunitetin LGBTI si pjesë e saj, si dhe detyrën e tij kushtetuese për të mbrojtur të drejtat individuale dhe kolektive<sup>19</sup>. Për më tepër, ai mori pjesë në marshin që shënoi Ditën Ndërkombëtare kundër Homofobisë dhe Transfobisë (IDAHOT), pranë aktivistëve të të drejtave të njeriut, dhe përfaqësuesve ndërkombëtar e vendas<sup>20</sup>. Këto veprime të rëndësishme nuk synojnë promovimin e entiteteve të caktuara politike ose liderëve politik, megjithatë duhet të theksohen duke i marrë si shembuj të mirë të përmbushjes së obligimeve kushtetuese dhe ligjore për promovimin e të drejtave të njeriut dhe barazisë; veçanërisht kur marrim parasysh kundërshtimin e madh shoqëror ndaj të drejtave LGBTI dhe diskriminimin e dhunën që burojnë prej këtij kundërshtimi.

**Kuvendi i Kosovës** në anën tjetër ka demonstruar një përkushtim kontradiktor, duke shfaqur shpeshherë një mospërputhje në mes të veprimeve pozitive dhe shkeljeve të obligimeve e detyrave ligjore. Përveç

miratimit të ligjeve progresive, Komisioni i Kuvendit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Humbur dhe Peticione, gjithashtu është treguar relativisht i hapur për bashkëpunim me organizata LGBTI. Edhe pse rekomandimet e një organizate LGBTI në lidhje me Planin e Veprimit të Komisionit të Kuvendit për vitin 2016<sup>21</sup> nuk janë marrë parasysh, në tetor 2016 Kuvendi i Kosovës organizoi takimin e Kuvendit me Asociacionin për të Drejta të Barabarta LGBTI për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë (ERA), ngjarje kjo në të cilën kryetarja e Komisionit të Kuvendit, Znjsh. Lirije Kajtazi, e dha fjalimin hyrës.

Pavarësisht kësaj, anëtarët e Kuvendit shpeshherë publikisht dhe privatisht përdorën gjuhë nënçmuese dhe të urrejtjes kundër komunitetit LGBTI. Rastet e përdorimit të gjuhës nënçmuese nga anëtarët e Kuvendit janë shënuar vazhdimisht. Për shembull, Z. Gëzim Kelmendi ka reaguar publikisht kundër të drejtave LGBTI, duke deklaruar se promovimi i tyre në formë të marsheve/paradave është i papranueshëm. "Njerëzit tonë nuk kanë nevojë për kësi lloj parade, [meqë] homoseksualiteti është sëmundje, dhe kjo është e dëshmuar në mënyrë shkencore... e gjithashtu është shkaktar kryesor i shkatërrimit të familjeve dhe i rënies së nivelit të popullsisë"<sup>22</sup>. Kjo deklaratë, meqë erdhi si vazhdimësi e deklaratave të ngjashme nga anëtarët

<sup>19</sup> "Fjalim nga Presidenti Hashim Thaçi në Ceremoninë e Inaugurimit", Presidenti i Republikës së Kosovës, 8 prill, 2016, qasur më 17 nëntor, 2016, [http://www.president-ksgov.net/?page=2,8,4328#\\_ÉC2DITKZOu0](http://www.president-ksgov.net/?page=2,8,4328#_ÉC2DITKZOu0).

<sup>20</sup> "Thaçi: Në Kosovë secili mund të dashurojë secilin", Zëri, 17 maj, 2016, qasur më 17 nëntor, 2016, <http://zeri.info/aktuale/90509/thaci-ne-kosove-secili-mund-te-dashuroje-secilin/>.

<sup>21</sup> Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione – Kuvendi i Republikës së Kosovës, 4 shkurt, 2016.

<sup>22</sup> Koalicioni për të Drejta të Barabarta për të Gjithë, Deklarata Dënuese nga Deputeti Kelmendi dhe Thirrje për Ndërmarrje të Veprime Disiplinore nga Kuvendi i Kosovës.(2016).



e Kuvendit, nxiti thirjen e organizatave të të drejtave të njeriut dhe LGBTI për veprime disiplinore nga Kuvendi i Kosovës dhe hetime të gjuhës së urrejtjes<sup>23</sup>, por këto nuk u morën parasysh. Më vonë, publikimet në media të përgjimeve të bisedave telefonike në mes të anëtarëve të Kuvendit shfaqën disa raste në të cilat zyrtarët përdorën gjuhë nënçmuese kundër komunitetit LGBTI<sup>24</sup>. Kjo me të vërtetë e ka zbuluar karakterin sipërfaqësor të përkushtimit institucional drejt vlerave që ata i miratojnë si ligje, si dhe papërgjegjësinë që e kanë për postet publike që i mbajnë.

**Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mosdiskriminim** (Zyra për Qeverisje të Mirë - ZQM) operon nën **Zyrën e Kryeministrit** si mekanizëm këshillues për fushat e qeverisjes së mirë, të drejtave të njeriut, mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimit, e gjithashtu ka rol mbikëqyrës dhe këshillues për ministritë për çështje të ngjashme. Në bazë të mandatit të kësaj zyreje<sup>25</sup>, Qeveria e Republikës së Kosovës në dhjetor 2014 themeloi Grupin Këshillues Koordinues (GKK) për të drejtat LGBTI<sup>26</sup>. GKK synon që të themelojë partneritet dhe bashkëpunim të rregullt në mes të institucioneve lokale dhe ndërkom-bëtare, dhe organizatave joqeveritare (OJQ-ve) që angazhohen për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave LGBTI dhe ndërmarrin aktivitete të përbashkëta për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit të

komunitetit LGBTI dhe për rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit për të drejtat e njeriut, me theks të veçantë në të drejtat LGBTI<sup>27</sup>; pra përbëhet prej përfaqësuesve të ministrive, prokurorisë, sistemit gjyqësor, policisë, dhe organizatave të të drejtave të njeriut dhe LGBTI.

Themelimi i GKK-së qartë ishte veprim i rëndësishëm institucional i përkushtimit për avancimin dhe promovimin e të drejtave LGBTI, por funksionimi i tij përballet me shumë sfida. Parimisht, përveç fushës së gjërë të veprimeve të GKK-së, brenda saj nuk ka rregulla dhe procedura, dhe kjo e pengon funksionimin në mënyrë të rregullt, veçanërisht sa i përket llogaridhënies dhe vendimmarrjes. Për shembull, nuk ka procedurë në fuqi që garanton pjesëmarrjen e rregullt të përfaqësuesve të institucioneve të emëruara, si të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe Ministrisë së Integritimit Evropian, që gati gjithmonë kanë munguar në këtë grup. Njëlloj nuk ka përcaktim të vendimmarrjes në grup, e kështu mundësohet vendimmarrja jolegjitime. Për më tepër, përfaqësues të institucioneve të caktuara nuk kanë fuqi që të kenë ndikim në vendime të politikëbërës brenda institucioneve të tyre; prandaj kjo është pengesë për koordinimin institucional dhe zbatimin e rekomandimeve të GKK-së. Kjo është manifestuar qartë në rastin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

<sup>23</sup> Ibid.

<sup>24</sup> Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë, Reagim ndaj Përdorimit të Gjuhës Poshtëruese nga Deputetët e Republikës së Kosovës, (2016).

<sup>25</sup> Rregulli Nr.16/2013 për Strukturën Organizative të Zyrës së Kryeministrit, neni 40/1.6, (2013).

<sup>26</sup> Vendimi Nr. 05/161, 2013.

<sup>27</sup> Ibid.



(MASHT), përfaqësuesja e së cilës nuk kishte mundësi që t'i jepte GKK-së informata të hollësishme për procesin e reformimit të kurrikulave dhe rishqyrtimit të librave shkollore. Gjithashtu, përfaqësuesja nuk ishte në gjendje që të themelonte një urë zyrtare të komunikimit në mes të grupeve punuese të MASHT dhe GKK.

Prej formimit, GKK ka hartuar dy Plan Vepërime; i pari për periudhën maj 2015 - maj 2016, dhe i dyti për periudhën nëntor 2016 – nëntor 2018. Ndonëse dokumenti i parë u synonte kryesisht kontributin e institucioneve të ndryshme për avancimin e politikave kundër diskriminimit, i dyti u avancua më tej duke pasqyruar kufizimet dhe mangësitë e planit fillestar. Në fushat kryesore që u adresuan në këtë draft plan përfshihen: përmirësimi i zbatimit të politikave kundër diskriminimit që rrjedhin nga ligji që është në fuqi, me fokus të veçantë në arsim, nëpërmjet reformës së vazhdueshme të kurrikulave, e në shëndetësi, nëpërmjet zbatimit të standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetit për mosdiskriminim; rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të qytetarëve për të drejtat LGBTI; rritjen e nivelit të bashkëpunimit ndërinstytucional brenda strukturës GKK; dhe për fund, përmirësimin e punës së GKK-së dhe rritjen e nivelit të efikasitetit të tij<sup>28</sup>. Sidoqoftë, gjatë vitit 2016, grupi u takua zyrtarisht vetëm dy herë - me 5 shkurt dhe me 2 mars - ndërsa me 16 mars organizuan "Konferencën e përbashkët për mbrojtjen e përfshirjes së trajnimit për rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit për barazi dhe të drejtat LGBT në institucionet publike të Kosovës",

ku rekomandimet<sup>29</sup> e GKK-së u prezantuan. Përveç këtyre rasteve, gjatë IDAHOT, GKK organizoi një konferencë tematike ku mblozhi përfaqësues lokal dhe ndërkombëtar si dhe aktivistë të të drejtave të njeriut, në të cilën ditë ndërtesa e Qeverisë u shndrit me ngjyrat e ylberit.

Gjithashtu, puna e GKK-së është plotësuar shumë nga *projekti dy-vjeçar binjakëzues i BE "Lufta kundër Homofobisë dhe Transfobisë"*, udhëhequr nga Instituti Austriak i të Drejtave të Njeriut Ludwig Boltzmann dhe mbështetur nga Instituti Kombëtar Finlandez për Shëndetësi dhe Mirëqenie, me synim të luftimit të homofobisë dhe transfobisë brenda institucioneve qeveritare, nëpërmjet ndërtimit të kapaciteteve të autoriteteve të Kosovës, si dhe në publik. Deri në përfundim të projektit në prill 2016, u ndërmorrën veprimet në vijim, në lidhje me punën e GKK-së:

*Disa trajnime të trajnerëve për shërbyes publik* që u miratuan paraprakisht nga GKK, u udhëhoqën prej ekspertëve të projektit binjakëzues të BE. Sidoqoftë, asnjëra prej organizatave LGBTI nuk u informua për përmbajtjet e trajnimit, e as për identitetin e trajnerëve, e kështu pati shqetësime në lidhje me garantimin e kualitetit për trajnimin, kryesisht meqë pjesëmarrësit e trajnuar treguan mungesë të diturisë themelore për çështjet LGBTI, përfshirë terminologjinë, dhe kjo është veçanërisht e rëndësishme, meqë ata duhet të trajnojnë kolegët e tyre për të drejtat dhe çështjet LGBTI.

<sup>28</sup> Republika e Kosovës – Zyra e Kryeministrit – Zyra për Qeverisje të Mirë, Draft Plani i Veprimit për Grupin Këshillues Koordinues dhe të Drejtat e Komunitetit (LGBT) për Periudhën nëntor 2016 – nëntor 2018.

<sup>29</sup> Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit – Zyra për Qeverisje të Mirë, "Rekomandime për Mbrojtjen e Përfshirjes së Qëndrueshmërisë së Trajnimeve të Rritjes së Nivelit të Ndërgjegjësimit për Barazi dhe të Drejtat e Komunitetit LGBT në Institucionet Publike të Kosovës", në Konferencën e përbashkët për mbrojtjen e përfshirjes së trajnimeve të rritjes së nivelit të ndërgjegjësimit për barazi dhe të drejtat LGBT në institucionet publike të Kosovës (Prishtinë, Kosovë, 2016).



*Udhërrëfyesit për atë se si duhet identifikuar diskriminimin (me fokus të veçantë në gjini dhe orientim seksual) në libra shkollor përfaqësojnë mjet të dobishëm për të ndihmuar MASHT në procesin e reformimit të kurrikulave dhe rishqyrtimit të librave shkollor, por nuk ka konfirmim zyrtar që ky dokument po shfrytëzohet nga grupet relevante punuese në MASHT; kjo mungesë e konfirmimit vjen parimisht për shkak të mungesës së komunikimit direkt në mes të grupit në fjalë dhe GKK. Njëlloj, *udhërrëfyesit për zhvillimin e një qasjeje strategjike drejt komunikimit për trajtim të barabartë të LGBTI në Kosovë* për Institucionet e Kosovës është dokument i dobishëm që u hartua për institucionet, por fatkeqësisht, nuk ka informata që po përdoret prej tyre deri më tani. Veç kësaj, është përpiluar një dokument me*

një shtjellim të shkurtër të monitorimit dhe vlerësimit, si dhe prezantimi i Mekanizmit Monitorues në Finlandë. Ky dokument që veç se është miratuar nga GKK rekomandon që GKK të shërbejë si *mekanizëm kombëtar i monitorimit dhe vlerësimit në lidhje me respektimin, mbrojtjen dhe promovimin e mosdiskriminimit dhe të drejtave LGBTI*. Ky rekomandim me të vërtetë nxiti debat për atë se a mund t'i jepet GKK-së ky rol, kur kemi parasysh se GKK është parimisht strukturë qeveritare, dhe si e tillë mund ta shkelë ndarjen e pushtetit dhe hierarkinë institucionale, si dhe të ndërhyjë në sferën e institucioneve të pavarura. Gjithashtu, e diskutueshme është se a mund të merrë GKK përgjegjësi për monitorimin e vetës, dhe nëse jo, kush do ta mbikqyrte punën e GKK-së.



## Zbatimi i ligjit për të drejtat LGBTI

Për një numër të madh të personave LGBTI, *policia* e kryeson listën e institucioneve për të cilat ata janë të vetëdijshëm, dhe ku përfundimisht do të raportonin raste të dhunës kundër tyre<sup>30</sup>. Kjo është kryesisht për shkak të ndërgjegjësimit të përgjithshëm dhe lehtësisë në qasje, më shumë se për besimin që e kanë në këtë institucion, që sigurisht se është dëmtuar prej rasteve të mëparshme që janë trajtuar me paaftësi dhe shkelje të ligjeve. Sidoqoftë, gjatë viteve të fundit janë bërë përpjekje të mëdha për të themeluar bashkëpunim të mirë në mes të organizatave LGBTI dhe policisë, me rezultate pozitive. Veçanërisht është shënuar një rritje në numrin e policëve që punojnë me komunitetin, ndërsa kurrikulat e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, të cilat i përdorin anëtarët e Policisë së Kosovës brenda kursit për të drejta të njeriut, i mbulojnë edhe të drejtat LGBTI.

Gjatë vitit 2016 u raportuan katër (4) raste në polici, prej të cilëve një (1) rast i shkeljes së supozuar të ligjit nga Policia e Kosovës gjatë trajtimit të një rasti LGBTI u dorëzua te Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) për hetime, dhe për të cilin nuk është dhënë ende përgjigje (shihni më poshtë "Rasti i çiftit gej që u dëbua me forcë nga banesa nga qiradhënësi i tyre", faqe 26). Gjithashtu, për shkak të mungesës së një mekanizmi të klasifikimit të të dhënave, ka mospërputhje në mes të të dhënave në disa raste që janë raportuar në polici dhe prokurori, dhe rasteve që janë trajtuar nga gjykatat. Kjo

është reduktuar deri në një pikë si rezultat i bashkëpunimit në mes të përfaqësuesve të këtyre institucioneve brenda strukturës GKK.

Ndërkohë, të dhënat prej studimeve të mëparshme i kanë shfaqur prokurorët si kundërshtuesit më të mëdhenj për të drejtat LGBTI nga të gjithë shërbyesit civil. Ndonëse një numër relativisht i vogël i prokurorëve të intervistuar pajtohen se ka dhunë kundër komuniteteit LGBTI, gjysma e tyre mendojnë se ka persona LGBTI në Kosovë, e njëri prej tyre madje deklaroi se të drejtat LGBTI nuk duhen mbrojtur<sup>31</sup>. Kjo nuk ka dhënë shumë shpresë sa i përket përmbushjes së padive për shkelje të të drejtave LGBTI.

Përveç shumë rasteve të dhunës, gjuhës së urrejtjes, dhe krimeve të urrejtjes në bazë të orientimit seksual, që kalojnë të padaluar nga prokuroria, ka tendencë për t'iu shmangur padive në këtë bazë, edhe në raste të raportuara. Në rastin që u raportua në prokurori në qershor 2016, kur dy burra ishin cak i dhunës nga ana e dy burrave të ri për shkak të orientimit të tyre seksual, gjykatat i dënoi autorët për krimin e shkaktimit të lëndimeve të lehta trupore, por i shkarkoi nga akuzat e nxitjes së urrejtjes, grindjes ose intolerancës kombëtare, racore, fetare ose etnike. Për më tepër, gjykata regjistroi që fyerjet u bazuan në orientim seksual, por jo edhe që shkeljet penale u kryen në këtë bazë, e kështu dështuan që të kualifikohen si krime të urrejtjes në bazë të orientimit seksual<sup>32</sup> (shihni më poshtë "Rasti i parë i zgjidhur nga gjykata", faqe 25).

---

<sup>30</sup> Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë dhe Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore, Liria dhe Mbrojtja për Lezbiket, Homoseksualët, Biseksualët dhe Transgjiorët në Kosovë, (Prishtinë, Kosovë, nëntor 2013).

<sup>31</sup> Ibid.

<sup>32</sup> Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore, Rast Studimi: Trajtimi i Rasteve LGBTI nga Sistemi i Drejtësisë në Kosovë, (Prishtinë, Kosovë, dhjetor 2016).



## Institucionet dhe mekanizmat e të drejtave të njeriut në relacion me të drejtat LGBTI

Pas sulmeve ndaj Kosovo 2.0 dhe organizatave LGBTI në fund të vitit 2012, Avokati i Popullit ishte radhitur në anën e duhur, duke mbrojtur fuqimisht të drejtat LGBTI në bazë të ligjit dhe mandatit institucional. Prej atëherë niveli i partneritetit në mes të Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) dhe organizatave LGBTI, si dhe komunitetit, është shtuar shumë. Përpyetje të vazhdueshme janë bërë për ta mbajtur gjallë këtë frymë të bashkëpunimit pas emërimit të Avokatit të ri të Popullit, Z. Hilmi Jashari, që vazhdimisht është deklaruar si i gatshëm për të bashkëpunuar për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave LGBTI. Megjithatë, në paraqitjet e tij publike në pozitën e Avokatit të Popullit, Z. Hilmi Jashari shpeshherë ka ngurruar që të luftojë bindshëm për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave LGBTI<sup>33</sup>, duke lënë kështu hapësirë për qëndrimin diskriminues shoqëror për ta sfiduar ligjin. Gjithashtu, ai dhe IAP nuk i janë përgjigjur gjithëmonë ftesave për aktivitete të organizatave LGBTI<sup>34</sup>.

Ngjashëm, në vend se të punojë që ta përmbush mandatin e institucionit të tij për promovimin e të drejtave të njeriut, përkatësisht të drejtave LGBTI, Z. Jashari ka pranuar se është angazhuar me organizimin e një studimi për homofobi<sup>35</sup>, studim ky i cili nuk është

përfunduar ende. Për më tepër, ai nuk ka përdorur kapacitetin e tij ligjor të amicus curiae për ta mbrojtur një rast të raportuar të krimin të supozuar të urrejtjes në bazë të orientimit seksual, siç premtoi në një takim me një organizatë LGBTI<sup>37</sup>, dhe siç deklaroi përsëri më pas. Madje as hetimi ex-officio i këtij rasti nuk është autorizuar, siç deklaruan përfaqësuesit e IAP. IAP gjithashtu nuk ka kthyer përgjigje me informata për rastin e Policisë së Kosovës, që u raportua nga viktimat dhe nga Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore<sup>38</sup>, dhe për këtë të njëjtin rast nuk ka nisur procedurë para gjykatës për diskriminim të supozuar në bazë të orientimit seksual për qasje në strehim, sipas kompetencave që jepen nga Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi (shihni më poshtë "Rasti i çiftit gej që u dëbua me forcë nga banesa prej qiradhënësit të tyre", faqe 26). Përkushtimi i pakursyer i IAP për avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave LGBTI është veçanërisht i rëndësishëm meqë përfaqëson mekanizmin kryesor të pavarur ligjor për mbrojtje, mbikëqyrje dhe promovim të të drejtave dhe lirive themelore të personave natyral dhe ligjor, nga veprimet e paligjshme, dështimet për të vepruar dhe veprimet e gabuara të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave ose organeve e organizatave tjera që ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës<sup>39</sup>; së fundmi është mandatar si mekanizëm i barazisë për trajtimin e rasteve të diskriminimit<sup>40</sup>, ndërkohë që raporti i parë i vonuar për këtë çështje<sup>42</sup> ende po pritet që të publikohet.

<sup>33</sup> "Avokati i Popullit Hilmi Jashari flet për shamtë dhe LGBT", Kallxo.com, 9 korrik, 2015, qasur me 6 dhjetor, 2016, <https://www.youtube.com/watch?v=JXwB-HYANJ0&feature=youtu.be>.

<sup>34</sup> Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore dhe Qendra për Liri dhe Barazi, shkresë elektronike për Shqipe Mala, 12 prill, 2015.

<sup>35</sup> Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore dhe Qendra për Liri dhe Barazi, shkresë elektronike për Institucionin e Avokatit të Popullit, 19 prill, 2016.

<sup>36</sup> Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore, shkresë elektronike për Hilmi Jashari dhe Arta Ibrahim, 21 shtator, 2016.

<sup>37</sup> Ibid.

<sup>38</sup> Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore, shkresë elektronike për Hilmi Jashari dhe Arta Ibrahim, 7 nëntor, 2016.

<sup>39</sup> Ligji 05/L-019 për Avokatin e Popullit, 2015, k.I/neni 1.

<sup>40</sup> Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, 2015, k.I, neni 9.

<sup>41</sup> Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, 2015, k. II, neni 9.

<sup>42</sup> Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, 2015, k.I, neni 9 (2.12).

**Njësitet e të Drejtave të Njeriut (NDNJ) në Komuna** janë një mekanizëm tjetër për promovimin e të drejtave të njeriut në nivel lokal<sup>43</sup>, pa marrë parasysh faktin se ligji i sapomiraturar për Mbrojtje nga Diskriminimi e ka shfuqizuar vendimin për themelimin e tyre<sup>44</sup>. Në anën tjetër, pavarësisht posedimit të përgjegjësive të përgjithshme<sup>45</sup>, këto njësite nuk ofruan asnjë kontribut për promovimin e të drejtave LGBTI deri më tani. Studimet e mëparshme kanë treguar nivel të lartë të paaftësisë së këtyre zyrtarëve të të drejtave të njeriut, sa i përket adresimit të të drejtave LGBTI<sup>46</sup>. Pavarësisht mungesës së nismës për të komunikuar me organizata LGBTI, që është pjesë e përgjegjësive të tyre, një pjesë e madhe e zyrtarëve të të drejtave të njeriut kanë dituri të kufizuar për çështjet dhe të drejtat LGBTI<sup>47</sup>, ndërsa në disa raste, është shprehur një mospranim total i komunitetit LGBTI ose një rezistencë ndaj të drejtave LGBTI<sup>48</sup>.

Për shembull, më 18 maj, 2016, në NDNJ në Komunën e Prishtinës u dorëzua një ankesë kundër një anëtari të stafit të Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Prishtinës, për abuzim verbal të një përfaqësuesi të një organizate LGBTI që kishte shkuar për të marrë miratim paraprak për përdorimin e hapësirës publike për të shënuar IDAHOT<sup>49</sup>.

‘Peder’, ‘Jena lodhë me aktivitete t’pederave’, duhet mi marr fmit me jetu në mal, që fmit e mi mos mi pa keto sene’, ‘Thuj Zhbogrit të shkon në vendin e vet me organizu ksi sene’, ‘Mangu na u deshën edhe më shumë pедера’, ishin shprehjet e zyrtarit të Komunës, kundër të cilit u dorëzua një ankesë për diskriminim (ngacmim) në bazë të orientimit seksual, në përputhje me Ligjin Kundër Diskriminimit<sup>50</sup>. Sidoqoftë, pavarësisht përkushtimit të shprehur nga Drejtori i Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim në Prishtinë, për moslejimin e çfarëdo rastit të sjelljes së keqe<sup>51</sup>, NDNJ ka qëndruar e heshtur ndaj këmbënguljes së ankuesit për të marrë informata mbi progresin e rastit, duke iu shmanhur komunikimit me shkrim. Asnjë informatë nuk është pranuar për rastin prej atëherë nga ndonjë zyrtar i Komunës së Prishtinës. Kjo me të vërtetë është çështje e rëndësishme që duhet të merret parasysh nga ZQM kur të hartohet legjislacioni dytësor që kërkohet nga Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, obligim ligjor që ZQM ka dështuar ta përmbush deri më tani, pavarësisht periudhës gjashtë (6) mujore që është përcaktuar me ligj<sup>52</sup>.

<sup>43</sup> Urdhëri Administrativ Nr. 2011/04 për Rregullimin dhe Plotësimin e Urdhërit Administrativ 2011/01 për Themelimin e Njësiteve për të Drejtat e Njeriut në Komuna, 2011, neni 1.

<sup>44</sup> Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, 2015, k. IV, neni 27 (1.5).

<sup>45</sup> Ibid, neni 7.

<sup>46</sup> Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë dhe Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore, Liria dhe Mbrojtja për Lezbiket, Homoseksualët, Biseksualët dhe Transgjjinorët në Kosovë, (Prishtinë, Kosovë, nëntor 2013).

<sup>47</sup> Ibid.

<sup>48</sup> Ibid.

<sup>49</sup> Agim Margilaj vs Komunës së Prishtinës – Departamenti për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, (2015) Ankesë.

<sup>50</sup> Ligji Nr.2004/3 Kundër Diskriminimit, 2004, k. I, neni 2(a), neni 3(c), neni 4(i)(m).

<sup>51</sup> Adrian Gashi, Shkresë elektronike për Agim Margilaj, 20 maj, 2015.

<sup>52</sup> Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, 2015, k.I, neni 11, k.IV, neni 26.



## Raportimi i mediave për çështje LGBTI

Raportimi i mediave në lidhje me komunitetin LGBTI është përmirësuar nga vitet e kaluara. Pa marrë parasysh nivelin e cekët dhe joadekuat të diturisë së gazetarëve për çështje dhe të drejta LGBTI, sidoqoftë është shfaqur një përmbajtje nga përdorimi i gjuhës fyese dhe nga raportimet fyese. Për më tepër, kur raportohet për çështje LGBTI dhe trajtohen ato, mediat e shtypit, si dhe ato elektronike, disi e kanë avancuar qasjen e tyre nga interpretimi fetar dhe moral, në interpretimin e të drejtave të njeriut. Sidoqoftë, trajtimi i komenteve fyese në media online vazhdon të jetë problem

serioz. Një raport i mëhershëm monitorues ka identifikuar mijëra komente të lexuesve në portale të ndryshme të lajmeve në të cilat janë fyer dhe poshtëruar komuniteti LGBTI, duke promovuar urrejtje dhe duke bërë thirrje për dhunë në bazë të orientimit seksual, e këto janë lejuar nga papërgjegjësia e mediave dhe politikat e tyre të redaktimit në fund të çdo jave. Një situatë e ngjashme pa përmirësime të dukshme ka vazhduar gjithashtu gjatë vitit 2016, duke bërë që komuniteti LGBTI të mbetet si cak kryesor i gjuhës së urrejtjes në komente në media online. Rrjedhimisht këto të fundit po shërbejnë si platformë e përforsimit të homofobisë.



## Kontributi i organizatave LGBTI

Përpjekjet për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave LGBTI dhe për fuqizimin e komunitetit LGBTI janë përçarur kryesisht në strukturën e aktiviteteve dhe në përkushtimin e tri OJQ-ve - Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore (CSGD), Qendra për Liri dhe Barazi (CEL) dhe Qendra për Emancipim Shoqëror (QESH). Aktivitetet e tyre kanë mbuluar disa fusha dhe kanë trajtuar probleme të ndryshme.

Përveç kontributit të tyre në GKK, organizatat LGBTI kanë ***nisur dhe vazhduar bashkëpunimin me disa institucione*** për të lehtësuar avancimin e të drejtave LGBTI,

dhe për të avokuar për to. Në këtë mënyrë, organizatat LGBTI brenda strukturës së Asociacionit ERA dhe në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës kanë organizuar konferencën e parë rajonale LGBTI të llojit të vet. Gjatë tri ditëve të ***konferencës "Pse ligjet nuk mjaftojnë!"*** (6-8 tetor) që mbledhi qindra përfaqësues të organizatave të të drejtave të njeriut dhe LGBTI, përfaqësues të qeverive nga Ballkani Perëndimor dhe Turqia, dhe përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar, u theksuan pengesat për zbatimin e ligjeve. Njëkohësisht, konferenca synoi që të themelojë një platformë rajonale ku autoritetet kombëtare dhe organizatat mund të shkëmbejnë praktikën më të mira dhe ta rrisin nivelin e dukshmërisë së lëvizjes LGBTI në rajon.

---

<sup>53</sup> Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Në Emër të Lirisë së Shprehjes, (Prishtinë, Kosovë, janar, 2014).



Pavarësisht krijimit të këti rrjeti të mirë rajonal, lëvizja LGBTI në Kosovë është e qendëruar në Prishtinë, dhe nuk ka prani në rajone tjera të vendit, e kështu përforcohet përshtypja ekzistuese shoqërore që e ngjason këtë lëvizje si kozmopolite. Prandaj, me qëllim të përballjes me këtë besim dhe të zgjerimit të shtrirjes së lëvizjes, u organizuan disa debate publike për promovimin e të drejtave LGBTI në Pejë, Prizren dhe Mitrovicën e Veriut. Rrjedhimisht, kjo ishte përpjekje për të ndërtuar partneritete dhe për të motivuar organizatat lokale të shoqërisë civile që të fusin çështjet LGBTI në fushën e aktiviteteve të tyre të veprimit. Ndonëse në nivel qendror, organizatat LGBTI veçse kanë ndërtuar koalicione me organizata tjera të të drejtave të njeriut, në mënyrë që ndikimi dhe efektiviteti i avokimit të tyre të shtohen. Ata i janë bashkuar Koalicionit të Drejta të Barabarta për të Gjithë (ERAC) që financohet nga BE dhe fokusohet në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave themelore të grupeve të prekshme dhe/ose të marginalizuara si komunitetet minoritare etnike, gratë, të rinjtë dhe komuniteti LGBTI.

Ndonëse dukshmëria e komunitetit LGBTI dhe pretendimi i tyre për realizimin e të drejtave të tyre siç garantohen prej ligjeve të Kosovës është shtuar nga **marshi IDAHOT** (17 maj) dhe një koncert që u organizua për herë të tretë radhazi në Prishtinë. Ndryshe nga marshet e kaluara, marshi i vitit 2016, i titulluar “Dashuria Jonë është Kushtetuese”, u bëri thirrje Qeverisë dhe Parlamentit të Republikës së Kosovës që ta rregullojnë Ligjin e Familjes<sup>54</sup> për ta legalizuar martesën në mes të personave të të njëjtit seks, në përputhje me të drejtat dhe parimet e përcaktuara në Kushtetutë<sup>55</sup>. Në marshin IDAHOT morën pjesë Presidenti i Republikës

së Kosovës, Z. Hashim Thaçi, ish-Presidentja, Znj. Atifete Jahjaga, Zëvendës Presidentja e Parlamentit Evropian, Znj. Ulrike Lunacek, Ambasadori i SHBA për Kosovë, Z. Greg Delawie, dhe shumë përfaqësues tjerë të qeverisë, komunitetit ndërkombëtar dhe shoqërisë civile, si dhe aktivistë të të drejtave të njeriut dhe LGBTI. Marshimi u bë në prani të madhe policore, por nuk u dallua ndonjë rrezik apo kërcënim i planifikuar, dhe kështu përfundoi në mënyrë paqësore. Por edhe me këtë përfundim, evenimenti u përçoll me reagime të kundërta të politikanëve dhe anëtarëve të Kuvendit, ndërsa pati përfaqësues të organizatave LGBTI që morën kërcënime me vdekje, raste këto të cilat u raportuan në polici. U shtua edhe numri i komenteve me gjuhë të urrejtjes në media online.

Për më tepër, dukshmëria e komunitetit LGBTI sigurisht se është ndikuar nga fushatat e rritjes së nivelit të ndërgjegjësimit. Në shtator 2016, CEL lansoi **fushatën “RAPORTO”** që nxiti personat LGBTI që të raportojnë rastet e dhunës ndaj tyre në polici, si dhe të raportojnë rastet e tyre në organizatën në fjalë, në qoftë se nuk janë të gatshëm që të raportojnë në polici. Kjo fushatë përdori mënyra të ndryshme të distribuimit të mesazhit, që u shoqërua gjithashtu me informata për ndihmë ligjore. Dhënë nivelin e lartë të ngurrimit të viktimave LGBTI sa i përket raportimit të rasteve, organizatat LGBTI në përgjithësi kanë bërë përpjekje që ta përmirësojnë këtë situatë dhe të mbështesin viktimat nëpërmjet shërbimit të ndihmës ligjore, që është ofruar vazhdimisht. Si rezultat i kësaj, ka patur rritje në numrin e rasteve të raportuara para institucioneve relevante.

<sup>54</sup> Ligji Nr.2004/32 Ligji për Familje i Kosovës, 2006, pjesa II, k.I, neni 9, neni 14.

<sup>55</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, k. II, neni 24, neni 37.



Në anën tjetër, gjatë vitit 2016, gjashtë (6) persona i kanë raportuar rastet e tyre në CEL, dy (2) prej të cilëve i ndihmuan që të arrijnë deri te strehimorja për LGBTI në Tiranë, Shqipëri - me kërkesë të viktimave. Të dy rastet kishin të bëjnë me kërcënime - fizike e psikologjike - me abuzim nga familjet e tyre, dhe kështu u detyruan që të jetojnë në një ambient të pasigurt. Për më tepër, katër (4) persona të tjerë kërkuan informata për procedura të **azilkërkimit**. Rastet e tilla ku kërkohet mbështetje për azilkërkim janë relativisht të zakonshme në mesin e personave LGBTI që përballen me dhunë në familje, diskriminim dhe ngacmim, por mbështetja që ofrohet nga organizatat LGBTI është e kufizuar në një letër mbështetjeje për viktimat që i raportojnë rastet e tyre në polici, ose për ata që nuk u kanë ndihmuar institucionet shtetërore. Të gjitha viktimat kanë refuzuar raportimin e rasteve të tyre përkatëse në polici, siç ndodh zakonisht në raste kur anëtarë të familjes janë autorë të krimit. Gjithashtu, CEL ka ofruar platformë të raportimit online për viktimat që kanë dëshirë të ruajnë anonimitetin. Katër (4) rastet e raportuara online deklaruan se kanë përjetuar ngacmime seksuale në familje dhe në hapësira publike (një (1) grua dhe dy (2) burra), dhe abuzim seksual në shkollë (një (1) burrë).

Meqë në shumë raste personat LGBTI nuk janë të vetëdijshëm për mbrojtjen ligjore që e kanë në dispozicion, dhe nuk e dinë se a aplikohet në rastet e tyre, ose si aplikohet, janë bërë përpjekje të vazhdueshme **për rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit dhe ndërtimin e kapaciteteve** të komunitetit LGBTI.

Sidoqoftë, duke patur parasysh faktin që numri i rasteve të raportuara nuk përfaqëson

diskriminimin real dhe dhunën e kryer ndaj personave që i përkasin komunitetit LGBTI, dhe se pasojat e këtyre pasqyrohen në mirëqenien e komunitetit, organizatat CEL dhe CSGD kanë ofruar **mbështetje psikologjike**. Të dhënat e profesionistëve të asociuar të psikologjisë dhe shëndetit mendor aludojnë një nivel të lartë të korrelacionit në mes të ambientit izolues/përrjashtues dhe dhunës psikologjike, si dhe vështirësive tjera të përballura. Rrjedhimisht, shumica e anëtarëve të komunitetit kanë kërkuar ndihmë për shkak të problemeve të lidhura me çrregullime emocionale (lloje të ndryshme të çrregullimeve të ankthit si ankthi i përgjithshëm ose ankthi shoqëror, si dhe çrregullime të depresionit); sjellje impulsive dhe kërcënuese (abuzim i alkoholit); probleme ndërpersonale (kryesisht konflikte në familje); ngacmim nga familja e shokët - që janë problemet kryesore; dhe probleme në marrëdhënie romantike. Një numër i vogël i klientëve janë diagnostifikuar me çrregullimin e stresit post-traumatik (traumë dhe abuzim seksual)<sup>56</sup>.

Si pasojë e shoqërisë jotolerante dhe nivelit të lartë të homofobisë që shpesh përvetësohet nga vet personat LGBTI, në shqetësimet kryesore të klientëve LGBTI përfshihen: (1) *kuptimi dhe pranimi i orientimit të tyre seksual* (shpeshherë vuajnë prej konflikteve të brendshme, si ndjenja të turpfit dhe neverisë, e njëkohësisht kanë nevojë për pranim të orientimit të tyre; në disa raste janë shënuar vetëm ndjenja të turpfit dhe të pakënaqësisë me vetën); (2) *menaxhimi i frikës nga demaskimi i orientimit të tyre seksual nga familja ose tjerët*; dhe (3) *zhvillimi i marrëdhënieve romantike afatgjate*<sup>57</sup>.

<sup>56</sup> Raporti m i brendshëm nga Fondacioni Kosovar për Shëndetësi, për Qendrën për Liri dhe Barazi (dhjetor 2016).

<sup>57</sup> Ibid.



Gjithashtu, për shkak të nivelit të lartë të prekshmërisë së komunitetit LGBTI ndaj infeksioneve seksualisht të transmetueshme, CSGD vazhdimisht ka punuar për **parandalim, këshillim dhe testim për Virusin HIV/AIDS**. Gjatë vitit 2016, shërbimet e CSGD-së i arritën një mijë e pesëqind (1500) persona, që

janë shërbyer një ose më shumë herë gjatë vitit. Në këtë aspekt u organizuan gjashtëqind (600) këshillime dhe testime për HIV/AIDS, dhe pesëdhjetëmijë (50000) kondomë e pesëdhjetëmijë (50000) lubrifikantë u dhanë për persona LGBTI.



## Sulmet ndaj aktivistëve LGBTI

Sulmet dhe kërcënimet ndaj aktivistëve LGBTI nuk janë të pazakonshme. Pas rasteve të tri kërcënimeve me vdekje kundër Rajmonda Sylbije dhe Arben Fejza që ndodhën në tetor 2014, pasi ata dhanë deklaratë publike në lidhje me Ditën Ndërkombëtare të të Dalurit Hapur, raste këto në lidhje me të cilat policia nuk ka dhënë asnjë informatë deri më sot, ndodhi edhe një rast i kërcënimit kundër Agim Margilaj.

Pasi komentoi në lidhje me situatën e të drejtave LGBTI në Facebook, Z. Margilaj pranoi një kërcënim publik nga një person që ai dikur e kishte shok të klasës.

*"Agim, pasha çka t'dush t'ishe konë i jemi t'kisha mytë me llovaçkë edhe as që m'kish ardhë marre. Edhe jo veç ty po çdo peder. Zoti qëllimisht i ka kriju dy gjini e ti po i mbronë bythqimtë. Mos gabo me m'dalë përpara se llom t'boj!"* ishin fjalët që iu adresuan viktimës. Disa ditë pasi ky rast u raportua në polici, autori i krimit e telefonoi viktimën disa herë duke kërkuar që ai ta tërheqë rastin. Viktima u kontaktua edhe nga babai i autorit të krimit, i cili kërkoi pajtim. Rasti nuk u tërhoq; disa muaj më vonë prokuroria e kontaktoi viktimën, i cili deklaroi se nuk ndihet më i rrezikuar nga autori i krimit, dhe rasti u mbyll.



## Mbrojtësit e rrejtshëm të të drejtave të njeriut

Përveç organizatave LGBTI, numri i organizatave të të drejtave të njeriut, të cilat promovojnë dhe avokojnë të drejta LGBTI brenda strukturës së përgjithshme të të drejtave të njeriut, është i kufizuar. Për shumicën e organizatave të të drejtave të njeriut, njëjtë si për shoqërinë në përgjithësi, të drejtat LGBTI përfaqësojnë çështje të turpfit të imponuara si normë perëndimore, e prandaj, duke dëshiruar që t'i shmangen "demonizimit të shoqërisë", që të mbesin brenda asaj që është e pranueshme nga shoqëria ose për ta mbrojtur vetën nga etiketimi i mundshëm me anëtarë të komunitetit LGBTI, ata evitojnë adresimin e këtyre të drejtave në diskursin e të drejtave të njeriut. Në njëfarë mënyre, ata kontribuojnë në mbajtjen e të drejtave LGBTI në sferën tabu.

Megjithatë, reduktimi i fondeve ndërkom-bëtare për Kosovën, përkatësisht tkurrja e fondeve për OJQ-të, e njëkohësisht prioritizimi i të drejtave LGBTI në agjendat e donatorëve që ndodhën në vitet e fundit i nxitën shumë OJQ që të përpilojnë projekte që kanë të bëjnë me avancimin e të drejtave LGBTI. Kjo në fakt e ka treguar një anë negative, duke bërë që organizatat për të cilat të drejtat LGBTI nuk përfaqësojnë vlerat e tyre, të zbatojnë projekte për hirë të ekzistencës së tyre, pa patur përkushtim të sinqertë ndaj avancimit të të drejtave të këtij komuniteti. Kjo shpeshherë është pasqyruar në qëndrimet kontradiktore dhe të rrejtshme

të këtyre organizatave, si dhe në (mos)veprimet e tyre. Në të vërtetë kjo kontradiktë në standardet e të drejtave të njeriut, nuk është e kufizuar nga mungesa e fondeve, por ka lulezuar nga një numër të madh i aktivistëve të rrejtshëm të të drejtave të njeriut që shërbejnë në shumë organizata me misione që lidhen me të drejtat e njeriut.

Veprimet kontradiktore të mbrojtësve të të drejtave të njeriut, promovuesve të sundimit të ligjit dhe stafit teknik që punojnë në OJQ që pretendojnë të udhëheqen nga parimi i mosdiskriminimit, më së shpeshi paraqiten në formë të postimeve fyese dhe nënçmuese kundër komunitetit LGBTI në rrjete sociale. Kështu në korrik 2016, CSGD dorëzoi një ankesë kundër një OJQ partnere<sup>58</sup>, saktësisht kundër një anëtarit të stafit të kësaj OJQ, me të cilin kishin bashkëpunim të afërt, për qëndrimet e tij homofobike dhe përhapjen e gjuhës së urrejtjes kundër komunitetit LGBTI në profilin e tij në Facebook. Ata gjithashtu kërkuan nga OJQ në fjalë që të ndërmerren hapa konkret në përputhje me rregullat e tyre të brendshme dhe ligjet në Kosovë<sup>59</sup>. Por organizata ka reaguar duke thënë se nuk kanë gjetur dëshmi të mjaftueshme për të justifikuar perceptimin e CSGD-së, dhe se ankesa e tyre ishte fyerje e madhe ndaj organizatës<sup>60</sup>. Pas këmbënguljes së CSGD-së, kjo OJQ i tërhoqi vërejtjen verbalisht anëtarit të stafit, i cili kërkoi falje më pas.

Më vonë, në dhjetor 2016, ndodhi një rast i ngjashëm. Një prej partnerëve të CSGD-së

<sup>58</sup> Për qëllime të konfidencialitetit dhe për hir të mos dëmtimit të reputacionit të OJQ-ve/Koalicionit në fjalë, emrat nuk do të zbulohen në këtë raport, ndërsa në referenca do të përmenden si Anonim.

<sup>59</sup> Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore, Shkresë elektronike për OJQ Anonime, 13 korrik, 2016.

<sup>60</sup> OJQ Anonime, përgjigje elektronike për Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore, 14 korrik, 2016.



dhe CEL-it në koalicion për të drejtat e njeriut shkroi një postim të turpshëm ku cak i kishte gratë, minoritetet etnike, rininë dhe komunitetin LGBTI. Meqë ky person e mbanë një pozitë të lartë në një organizatë që është e përkushtuar për dokumentimin dhe adresimin e rasteve të diskriminimit, gjuhës së urrejtjes dhe dhunës ndaj popullsisive më të prekshme në Kosovë, si gratë, komunitetet etnike dhe komuniteti LGBTI, shkelësi u përball me një ankesë fillestare nga organizatat LGBTI<sup>61</sup>, e më pas një

ankesë të përbashkët të tërë koalicionit<sup>62</sup>. Përveç dënimit të qëndrimit të partnerit, kjo ankesë thekson shqetësimin që shërbimet e ofruara nga ajo OJQ nuk mund të merren si të drejta dhe të paanshme, e kështu edhe vënë në dyshim përshtatshmërinë e ndihmës së tyre për viktimat e dhunës dhe diskriminimit. Në fund ka mbetur që OJQ në fjalë që t'i ofrojë koalicionit një propozim për masat që do të merren në lidhje me këtë rast.

---

<sup>61</sup> Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore, Shkresë elektronike për Koalicion Anonim, 5 dhjetor, 2016.

<sup>62</sup> Takim i Koalicionit Anonim, 7 dhjetor, 2016.



## Rastet e raportuara para institucioneve relevante

### 1. Rasti i parë i zgjidhur nga gjykata

Në qershor të këtij viti, dy burra gej, punëtorë të CSGD-së, ishin cak i dhunës deri sa po kryenin aktivitete për kontaktimin e komunitetit LGBTI. Derisa njëri prej viktimave po kryente aktivitete në një hapësirë publike, atij iu afruan dy burra, të cilët filluan ta pyesin për aktivitetin e tij, e pastaj filluan ta sulmonin verbalisht dhe fizikisht. Ndërkohë, viktima tjetër që po hante në një lokal të ushqimit të shpejtë aty afër u thirr me fjalë fyese dhe u sulmua fizikisht nga njëri prej kriminelëve, ndërsa kriminelin tjetër e parandaloi atë që të mos ikte.

Ky rast u raportua në polici, dhe pasi kjo e fundit erdhi në skenën e krimit, arrestoi njërin prej kriminelëve, ndërsa tjetri arriti që të ikte. Më pas, viktima vizitoi doktorin, në raportin e të cilit u shkrua për lëndime relativisht të lehta në anën e djathtë të fytyrës, rreth syrit dhe hundës. Pas dëshmisë së viktimave, në të cilat ata haptas deklaruan se orientimi i tyre seksual dhe aktivitetet e tyre ishin motivi kryesor për sulmin, rasti u procesua më tej në Zyrën e Prokurorit Themelore, që rezultoi me një padi kundër dy kriminelëve. Padia u bazua në dy shkelje penale: 1) nxitje e urrejtjes, grindjes ose intolerancës kombëtare, racore, religjioze ose etnike, në kundërshtim me nenin 147, paragrafin 1, të KPRK, e kryer në bashkëpunim, në kundërshtim me nenin 31 të KPRK; dhe 2) sulm në

kundërshtim me nenin 187, paragrafin 1, të KPRK, e kryer në bashkëpunim, në kundërshtim me nenin 31 të KPRK<sup>63</sup>.

Me vendim të gjykatës të procedurës paraprake, kriminelët u mbajtën nën arrest shtëpiak prej 14 qershor 2016, deri me 13 korrik 2016. Sidoqoftë, në seancën e parë dhe të dytë të Gjykatës Themelore, njëri prej autorëve të krimit mungoi, ndërsa në të tretën ai u soll në Gjykatë nga policia me urdhër të gjykatës të rastit, në po atë ditë kur Gjykata Themelore e shpalli fajtor kriminelin kryesor në këtë shkelje penale, për nxitje të urrejtjes dhe shkelje penale me anë të shkaktimit të lëndimeve të lehta trupore, pas rikualifikimit të shkeljes penale të Sulmit, në shkelje penale të shkaktimit të lëndimeve të lehta trupore, dhe e dënoi me kohë efektive në burg pesë (5) muaj. Ndërsa i pandehuri i dytë nuk u shpall fajtor për shkeljen penale të nxitjes së urrejtjes, por u shpall fajtor për shkeljen penale të shkaktimit të lëndimeve të lehta trupore, të kryera në bashkëpunim me të pandehurin kryesor, dhe u dënua me katër (4) muaj në burg, që u pezullua me kusht që i pandehuri nuk kryen ndonjë shkelje tjetër penale për një periudhë një (1) vjeçare. Me këtë vendim, Gjykata cekti se viktimat u fyen në bazë të orientimit seksual, por nuk deklaruan se shkeljet penale u kryen për shkak të orientimit seksual të viktimave<sup>64</sup>.

<sup>63</sup> Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore, Rast Studimi: Trajtimi i Rasteve LGBTI nga Sistemi i Drejtësisë në Kosovë, (Prishtinë, Kosovë, dhjetor 2016).

<sup>64</sup> Ibid.



## 2. Rasti i çiftit gej që u dëbua me forcë nga banesa prej qiradhënësit të tyre

Një çift gej që jetuan në një banesë me qira u sulmuan fizikisht dhe u fyen verbalisht nga qiradhënësi i tyre dhe familja e tij për shkak të orientimit të tyre seksual. Kur qiradhënësi zbuloi se qiramarrësit e tij ishin çift gej, ai i fyu dhe i sulmoi fizikisht ata, duke u shkak-tuar lëndime trupore, traumë psikologjike, dhe duke i lënë viktimat përkohësisht të pastrehë. Pas sulmit fizik, viktimat e raportu-an rastin në polici. Pas dhënies së deklarat-ave nga ana e viktimave, policia i shoqëroi ata për të marrë gjërat personale nga bane-sa me qira. Qiradhënësi përsëri i fyu dhe i kërcënoi viktimat, këtë herë në prani të dy dëshmitarëve dhe tetë policëve.

*“Pedera... nuk munëni me m’ikë... ju gjej edhe n’Amerikë nëse mrrini atje”* ishin fjalët kërcënuese të qiradhënësit që i tha kundër viktimave në prani të policisë. Megjithatë, pavarësisht faktit se policët ishin dëshmitarë të një kërcënimi direkt të dokumentuar në raportin e tyre, nuk u ndërmorrën veprime të mëtejme prej tyre. Ndërsa prej korrikut 2016, kur rasti ndodhi, viktimat nuk kanë marrë ndonjë informatë të mëtejme për progresin e rastit të tyre.

Viktimat dhe përfaqësuesit e CSGD-së dorëzuan një ankesë në Policinë e Kosovës dhe në IAP, duke vënë në dyshim lig-jshmërinë e mosveprimit të policisë drejt kërcënimeve të qiradhënësit ndaj viktimave në praninë e tyre, meqë sipas viktimave, kur e raportuan rastin, policia i siguroi ata se në qoftë se nuk do të lejoheshin nga qiradhënësi që t’i merrnin gjërat e tyre personale ose në rast se do të sulmo-

heshin nga ai, policia do ta arrestonte atë. Por, ngjashëm me Policinë e Kosovës, IAP nuk u dha viktimave ose përfaqësuesve të CSGD-së informata për progresin e rastit, dhe nuk nisi procedurë për diskriminim të supozuar për qasje në strehim në bazë të orientimit seksual.

## 3. Rasti i dhunës kundër një të mituri

Në qershor të këti viti, një fëmijë mashkull që ishte viktimë e dhunës në familje në bazë të perceptimit se i përket komunitetit LGBTI iu referua për mbështetje CSGD-së, të cilët menjëherë i ndihmuan viktimës që ta raportonte rastin në stacionin e policisë, në njësitin përkatës për dhunë në familje.

Policia e informoi Zyrtarin për Mbrojtje të Viktimave dhe Qendrën për Punë Sociale që të jenë të pranishëm gjatë të gjitha hap-ave procedural të intervistimit të viktimës. Megjithatë, vetëm Zyrtari për Mbrojtje të Viktimës iu pergjigj thirrjes, e prandaj policia nuk kishte zgjedhje tjetër përveç se të vazh-donte me rastin pa praninë e përfaqësuesve të Qendrës për Punë Sociale. Viktima u mbajt në strehimore për viktimë të dhunës në familje për një ditë.

Meqë ky ishte rast i dhunës në familje dhe viktimë fëmijë mohoi përkatësinë në komu-nitetin LGBTI, CSGD konsideroi që ky rast nuk i përket sferës së punës së organizatës; prandaj rasti iu referua një organizatës kom-petente - Terre Des Hommes. Informata e marrë nga kjo organizatë tregon se viktimë ka mbetur në strehimore për vetëm 24 orë dhe është kthyer më pas tek familja



#### 4. Rasti para Gjykatës Themelore - Departamenti i Krimeve të Rënda

Në maj të vitit 2015, një burrë gej u përdhunua në vendin e tij të punës nga kolegu i tij gjatë orarit të punës. Rasti u raportua në polici në po atë ditë, dhe aktualisht është duke u zhvilluar në Departamentin e Krimeve të Rënda në Gjykatën Themelore. Deri më tani janë mbajtur nëntë seanca në gjykatë, dhe e dhjeta është planifikuar për datën 30 dhjetor, 2016.

Padia i përket Shkeljeve Kundër Integritetit Seksual, gjegjësisht Shkeljes së Përdhunimit nën Nenin 230 të KPRK, për të cilën i akuzuari qëndroi për tetë (8) muaj në paraburgim, dhe aktualisht është nën arrest shtëpiak.

Me 29 shtator, 2016, viktimia iu referua për mbështetje CSGD-së. Në bazë të informatave të rastit që u raportua nga viktimia, CSGD i ofroi atij ndihmë ligjore pa pagesë, duke i caktuar një avokat për ta përfaqësuar viktimën para gjykatës. Në seancën e gjykatës me 11 shtator, avokati e përfaqësoi viktimën para panelit gjykues, ndërsa viktimës iu ofrua gjithashtu mbështetje psikologjike për shkak të traumës së përjetuar. Megjithatë, trauma e rëndë bëri që viktimia të kërkojë ndihmë në Klinikën Psikiatrike të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, dhe aktualisht është duke iu nënshtruar terapisë në shtëpi.



## Rekomandime

1. Institucionet relevante duhet të rishqyrtojnë legjislacionin parësor dhe dytësor për të iu mundësuar personave transgjnorë që ta ndryshojnë seksin në dokumente identifikuese;
2. Nxitja e gjuhës së urrejtjes dhe krimit të urrejtjes në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor duhet të kriminalizohet nga Kodi Penal;
3. Ligji i Familjes duhet të rishikohet në mënyrë që të legalizohet martesë në mes të personave të të njëjtit seks;
4. Kuvendi i Kosovës duhet të angazhohet haptazi për promovimin e të drejtave LGBTI;
5. ZQM duhet ta përmbush obligimin e saj ligjor për të hartuar aktet nënligjore në përputhje me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi sa më parë;
6. ZQM duhet të mbikëqyrë në mënyrë efektive ministritë sa i përket progresit në zbatimin e rekomandimeve të GKK-së, dhe kur është e nevojshme të ndërmerre veprime konkrete për të garantuar zbatimin e tërësishëm të këtyre rekomandimeve;
7. ZQM duhet të forcojë burimet njerëzore dhe ta caktojë të paktën një anëtar stafi për t'u angazhuar parimisht me punën e GKK-së dhe çështjet LGBTI;
8. GKK duhet të hartojë rregullat dhe procedurat e veta;
9. ZQM, si lider i GKK-së, duhet të raportojë para grupit për zbatimin e planit të punës;
10. Duhet të hyjë në fuqi një modalitet i mekanizmit të monitorimit dhe vlerësimit për të drejtat LGBTI që më së miri i përshtatet kontekstit dhe përbërjes institucionale të Kosovës;
11. Duhet të krijohet një mekanizëm i klasifikimit për gjuhë dhe krime të urrejtjes në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor pas rishqyrtimit të KPRK;
12. Avokati i Popullit të Kosovës duhet të angazhohet në mënyrë aktive për promovimin e të drejtave LGBTI, kryesisht nëpërmjet mediave dhe organizimeve tjera publike;
13. Duhet të shtohet bashkëpunimi në mes të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe organizatave LGBTI;
14. Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës duhet të inkurajojë redaktorët e portaleve online që të gjejnë mënyra më të përshtatshme për të kontrolluar komentet fyese;
15. OJQ-të duhet të jenë më gjithëpërfshirëse në promovimin e të drejtave të njeriut;
16. OJQ-të duhet të jenë më të vëmendshme kundrejt abuzimit të parimeve të të drejtave të njeriut nga stafi i tyre.



Supported by the European Union



Financed by:



Supported by